Në bazë të nenit 35, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenit 65 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77 / 16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.10/ 03 prill 2017, Prishtinë) dhe në bazë të nenit 96 paragrafit 5 nenit 135të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e tij të mbajtur më 17 dhjetor 2024, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR NJOFTIMIN E BANKËS QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR INCIDENTET MADHORE OPERACIONALE APO TË SIGURISË

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo Rregullore përcakton kriteret për klasifikimin e incidenteve madhore operacionale ose të sigurisë nga ofruesit e shërbimeve të pagesave, si dhe formatin dhe procedurat që ata duhet t'i ndjekin për raportimin e incidenteve të tilla tek Banka Qendrore e Kosovës, në përputhje me nenin 96 të Ligjit Nr.08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.
2. Kjo Rregullore definon mënyrën e klasifikimit dhe raportimit të incidenteve të mëdha operacionale ose të sigurisë në përputhje me nenin 96 të Ligjit Nr.08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.
3. Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave që janë të licencuar, autorizuar ose regjistruar për të ofruar shërbime të pagesave në Kosovë në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.
4. Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha incidentet që bien nën përkufizimin e "incidentit madhor operacional ose të sigurisë", të cilat përfshijnë ngjarje të jashtme dhe të brendshme që mund të jenë ose me synime keqdashëse ose aksidentale.
5. Kjo Rregullore gjithashtu zbatohet edhe në rastet kur incidentet madhore operacionale ose të sigurisë e kanë origjinën nga vende tjera jashtë Kosovës (p.sh. kur një incident e ka origjinën në kompaninë mëmë ose në ndonjë filial të themeluar jashtë Kosovës) dhe ndikojnë në shërbimet e pagesave të ofruara nga ofruesi i shërbimeve të pagesave që ndodhet në Kosovë, qoftë drejtpërdrejt (kur shërbimi i pagesave ofrohet nga kompania jashtë Kosovës) ose tërthorazi (kur aftësia e ofruesit të shërbimit të pagesave për të vazhduar aktivitetin e pagesave rrezikohet në një mënyrë tjetër si pasojë e incidentit).

6. Kjo Rregullore zbatohet gjithashtu edhe në rastet e incidenteve madhore që ndikojnë funksionet e jashtëkontraktuara tek palët e treta nga ofruesit e shërbimeve të pagesave.

Neni 2
Përkufizimet

1. Termat dhe përkufizimet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.
2. Përveç paragrafit 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj Rregulloreje, termat dhe shkurtesat e mëposhtme kanë këtë kuptim:
   2.1. **"Disponueshmëri"** nënkupton karakteristikat e shërbimeve të lidhura me pagesat që janë plotësisht të qasshme dhe të përdorshme nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave (PSHP-të), sipas niveleve të pranueshme të paracaktuara nga ofruesi i shërbimit të pagesave (OSHP);
   2.2. **"Autenticitet"** nënkupton karakteristikat e një burimi për të qenë ai që pretendon të jetë;
   2.3. **"BQK"** nënkupton Bankën Qendrore të Kosovës;
   2.4. **"Konfidencialitet"** nënkupton karakteristikat që informatat të mos u vihen në dispozicion ose t'u zbulohen individëve, subjekteve ose proceseve të paautorizuara;
   2.5. "**Transaksion i pagesave ndërkufitare"** nënkupton transaksionet e pagesave të iniciuara nga kryerësi i pagesës ose nga marrësi e pagesës ku OSHP-ja e kryerësit të pagesës ose marrësit të pagesës ndodhet në Kosovë dhe tjetra OSHP ndodhet jashtë Kosovës si dhe brenda zonës SEPA;
   2.6. **"Integritet"** nënkupton karakteristikat e ruajtjes së saktësisë dhe të plotësisë së aseteve, duke përfshirë të dhënat;
   2.7. **"Incident operacional ose i sigurisë"** nënkupton një ngjarje të vetme ose një seri ngjarjesh të lidhura, të paplanifikuara nga OSHP, që ka ose ka të ngjarë të ketë një ndikim negativ në integritetin, disponueshmërinë, konfidencialitetin dhe/ose autenticitetin e shërbimeve të lidhura me pagesat;
   2.8. **"Shërbime të lidhura me pagesat"** nënkupton çdo aktivitet afarist sipas kuptimit të nënparagrafit 1.2 të paragrafit 1 të nenit 4 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, dhe të gjitha detyrat e nevojshme mbështetëse teknike për ofrimin e saktë të shërbimeve të pagesave;
   2.9. **"Ligji për Shërbimet e Pagesave"** nënkupton Ligjin Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave;
   2.10. **"OSHP"** nënkupton ofruesin e shërbimeve të pagesave siç përcaktohet në Ligjin për Shërbimet e Pagesave;
   2.11. **"PSHP"** nënkupton përdoruesin e shërbimit të pagesave siç përcaktohet në Ligjin për Shërbimet e Pagesave.
   2.12. "**Zonë SEPA**" nënkupton shtrirjen gjeografike të skemave SEPA siç përcaktohet nga kriteret e përcaktuara nga Këshilli Evropian i Pagesave (EPC).

KAPITULLI II
NJOFTIMI I BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS NË LIDHJE ME INCIDENTET MADHORE OPERACIONALE APO TË SIGURISË

Neni 3
Klasifikimi si incident madhor

1. OSHP-të duhet t'i klasifikojnë incidentet operacionale ose të sigurisë si të mëdha nëse plotësojnë kriteret e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni dhe vlerësimin e përcaktuar në këtë rregullore, si në vijim:

   1.1. plotëson një ose më shumë nga kriteret në kategorinë "ndikim i lartë"; ose

   1.2. plotëson tre ose më shumë nga kriteret në kategorinë "ndikim i ulët".

2. OSHP-të duhet ta vlerësojnë një incident operacional ose të sigurisë në bazë të kritereve të mëposhtme dhe treguesve të tyre bazë:

   2.1. *transaksionet e prekura nga incidenti*: OSHP-të duhet ta përcaktojnë vlerën totale të transaksioneve të prekura, si dhe numrin e pagesave të kompromentuara si përqindje e nivelit të rregullt të transaksioneve të pagesave të kryera nëpërmjet shërbimeve të pagesave të prekura nga incidenti;

   2.2. *PSHP-të e prekura nga incidenti*: OSHP-të duhet ta përcaktojnë numrin e PSHP-ve të prekura, si në vlerë absolute ashtu edhe në përqindje të numrit të përgjithshëm të PSHP-ve;

   2.3. *shkelja e sigurisë së rrjetit ose sistemeve të informacionit*: OSHP-të duhet të përcaktojnë nëse ndonjë veprim keqdashës ka kompromentuar sigurinë e rrjetit ose të sistemeve të informacionit në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave;

   2.4. *kohëzgjatja e ndërprerjes së shërbimit*: OSHP-të duhet ta përcaktojnë periudhën gjatë së cilës shërbimi ka të ngjarë të mos jetë i disponueshëm për përdoruesin e shërbimit të pagesave ose gjatë së cilës urdhërpagesa, siç përcaktohet në nënparagrafin 1.12 të paragrafit 1 të nenit 4 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, nuk mund të realizohet nga OSHP-ja;

   2.5. *ndikimi ekonomik*: OSHP-të duhet t'i përcaktojnë kostot monetare të lidhura me incidentin në mënyrë gjithëpërfshirëse duke marrë parasysh vlerën absolute dhe, kur është e aplikueshme, edhe rëndësinë relative të këtyre kostove në raport me madhësinë e OSHP-së (pra, në raport me kapitalin e nivelit të parë të OSHP-së);

   2.6. *niveli i lartë i përshkallëzimit të brendshëm*: OSHP-të duhet të përcaktojnë nëse ky incident është raportuar apo do t'u raportohet zyrtarëve të tyre ekzekutivë;

   2.7. *OSHP-të e tjera ose infrastrukturat përkatëse që mund të preken nga incidenti*: OSHP-të duhet të përcaktojnë implikimet sistemike që ka të ngjarë të ketë incidenti, pra, mundësia që efekti i incidentit të përhapet përtej OSHP-së së prekur fillimisht te OSHP-të e tjera, infrastrukturat e tregut financiar dhe/ose skemat e pagesave;

   2.8. *ndikimi reputacional*: OSHP-të duhet të përcaktojnë se si incidenti mund ta minojë besimin e përdoruesve tek OSHP-ja dhe, në përgjithësi, në shërbimin themelor ose tregun në tërësi.

3. OSHP-të duhet ta llogarisin vlerën e treguesve sipas metodologjisë së mëposhtme:

3.1. transaksionet e prekura nga incidenti:

3.1.1. si rregull i përgjithshëm, OSHP-të duhet t'i kuptojnë si "transaksione të prekura nga incidenti" të gjitha transaksionet brenda vendit dhe ato ndërkufitare që janë ndikuar ose ka të ngjarë të ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga incidenti dhe, në veçanti, ato transaksione që nuk mund të iniciohen ose të procesohen, ato transaksione për të cilat është ndryshuar përmbajtja e mesazhit të pagesës dhe ato transaksione që janë urdhëruar me qëllim mashtrimi (pavarësisht nëse fondet janë rikuperuar apo jo), ose kur ekzekutimi i saktë pengohet në ndonjë mënyrë tjetër nga incidenti;

3.1.2. për incidentet operacionale që ndikojnë në aftësinë për t'i iniciuar dhe/ose për t'i procesuar transaksionet, ofruesit e shërbimeve të pagesave raportojnë vetëm ato incidente me kohëzgjatje më të gjatë se një orë. Kohëzgjatja e incidentit matet që nga momenti kur ndodh incidenti, deri në momentin kur aktivitetet normale/operacionet e zakonshme janë rikuperuar në nivelet e shërbimit të ofruara para incidentit;

3.1.3. për më tepër, OSHP-të konsiderojnë si nivel të rregullt të transaksioneve të pagesave mesataren ditore të transaksioneve vjetore të pagesave brenda vendit dhe ato ndërkufitare të kryera nëpërmjet të njëjtave shërbime pagesash që janë prekur nga incidenti, duke konsideruar vitin e mëparshëm si periudhë referimi për llogaritjet. Në rast se OSHP-të nuk e konsiderojnë këtë vlerë si përfaqësuese (p.sh. për shkak të sezonalitetit), ata përdorin një metrikë tjetër, më përfaqësuese, dhe njoftojnë BQK-në për arsyet e ndjekjes së kësaj qasjeje, nëpërmjet plotësimit të fushës përkatëse të formularit të raportimit të dhënë në shtojcë.

3.2. PSHP-të e prekura nga incidenti:

3.2.1. OSHP-të duhet t'i kuptojnë si "PSHP të prekura nga incidenti" të gjithë klientët (qoftë brenda vendit ose nga jashtë, konsumatorë ose korporata) që kanë një kontratë me ofruesin e shërbimeve të pagesave, të prekur nga incidenti, që iu jep atyre qasje në shërbimin e pagesës të prekur nga incidenti, dhe që janë ndikuar ose mund të ndikohen nga pasojat e incidentit. OSHP-të përdorin vlerësime të bazuara në aktivitetin e tyre të mëparshëm, për ta përcaktuar numrin e PSHP-ve që mund të kenë përdorur shërbimin e pagesave gjatë kohëzgjatjes së incidentit;

3.2.2. në rastin e grupeve, secili ofrues i shërbimeve të pagesave merr në konsideratë vetëm përdoruesit e tij të shërbimeve të pagesave. Në rastin e një ofruesi të shërbimeve të pagesave që ofron shërbime operacionale për të tjerët, ai ofrues i shërbimit të pagesës merr në konsideratë vetëm përdoruesit e tij të shërbimeve të pagesave (nëse ka), dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave që marrin këto shërbime operacionale e vlerësojnë incidentin në lidhje me përdoruesit e tyre të shërbimeve të pagesave;

3.2.3. për incidentet operacionale që ndikojnë në aftësinë për të iniciuar dhe/ose për të procesuar transaksionet, ofruesit e shërbimeve të pagesave raportojnë vetëm ato incidente që cenojnë përdoruesit e shërbimeve të pagesave për një kohëzgjatje më të gjatë se një orë. Kohëzgjatja e incidentit matet që nga momenti kur ndodh incidenti, deri në momentin kur aktivitetet normale/operacionet e zakonshme janë rikuperuar në nivelet e shërbimit të ofruara para incidentit;

3.2.4. për më tepër, OSHP-të konsiderojnë si numër total të PSHP-ve, shumën e agreguar të përdoruesve të shërbimeve të pagesave brenda dhe jashtë vendit, të lidhur në mënyrë kontraktuale me ofruesit e shërbimeve të pagesave në kohën e incidentit (ose, në mënyrë alternative mund të përdorin, vlerën më të fundit të disponueshme) dhe me qasje në shërbimin e pagesave të prekur nga incidenti, pavarësisht nga madhësia e tyre, ose nëse ata konsiderohen përdorues aktivë ose pasivë të shërbimit të pagesës.

3.3. shkelja e sigurisë së rrjetit ose sistemeve të informacionit:

3.3.1. OSHP-të vlerësojnë nëse ndonjë veprim keqdashës ka rrezikuar disponueshmërinë, autenticitetin, integritetin ose konfidencialitetin e rrjetit ose sistemeve të informacionit (përfshirë të dhënat), në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave.

3.4. kohëzgjatja e ndërprerjes së shërbimeve:

3.4.1. OSHP-të duhet të marrin në konsideratë periudhën kohore kur çdo detyrë, proces ose kanal në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave është ndërprerë ose ka të ngjarë të ndërpritet, duke penguar në këtë mënyrë i) inicimin dhe/ose ekzekutimin e një shërbimi pagese dhe/ose ii) qasjen në një llogari pagese. OSHP-të llogarisin kohën e ndërprerjes së shërbimit që nga momenti i inicimit fillimit të ndërprerjes së shërbimit dhe marrin në konsideratë si intervalet kohore gjatë orarit zyrtar të punës siç kërkohet për kryerjen/ekzekutimin e shërbimeve të pagesave, ashtu edhe orët jashtë orarit zyrtar të punës dhe periudhat e mirëmbajtjes, kur është e përshtatshme dhe e zbatueshme. Nëse OSHP-të nuk janë në gjendje të përcaktojnë se kur filloi ndërprerja e shërbimit, në mënyrë përjashtimore ata llogarisin ndërprerjen e shërbimit që nga momenti kur zbulohet ndërprerja e shërbimit.

3.5. ndikimi ekonomik:

3.5.1. OSHP-të duhet t’i marrin parasysh si kostot që mund të lidhen drejtpërdrejt me incidentin ashtu edhe ato që lidhen në mënyrë të tërthortë me incidentin. Ndër të tjera, OSHP-të duhet të marrin në konsideratë fondet ose asetet e shpronësuara, kostot e zëvendësimit të harduerit ose softuerit, kostot e tjera mjeko-ligjore ose të riparimit, tarifat për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sanksionet, detyrimet e jashtme dhe të ardhurat e humbura. Për sa i përket kostove të tërthorta, OSHP-të duhet të marrin në konsideratë vetëm ato që janë tashmë të njohura ose me shumë gjasa të materializohen.

3.6. niveli i lartë i përshkallëzimit të brendshëm:

3.6.1. OSHP-të duhet të marrin në konsideratë nëse, si rezultat i ndikimit në shërbimet e lidhura me pagesat, organi drejtues është informuar siç përcaktohet në Rregullore për teknologjia e informacionit dhe komunikimit - TIK dhe menaxhimin e rrezikut të sigurisë, për incidentin jashtë çdo procedure njoftimi periodik dhe në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së incidentit. Për më tepër, OSHP-të duhet të marrin në konsideratë nëse, si rezultat i ndikimit të incidentit në shërbimet e lidhura me pagesat, është shkaktuar ose ka të ngjarë të shkaktohet një gjendje krize.

3.7. OSHP-të e tjera ose infrastrukturat përkatëse që mund të preken nga incidenti:

3.7.1. OSHP-të duhet ta vlerësojnë ndikimin e incidentit në tregun financiar, që nënkupton infrastrukturën e tregut financiar dhe/ose skemat e pagesave që e mbështesin atë dhe

ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave. Në veçanti, ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të vlerësojnë nëse incidenti ka ndodhur ose ka të ngjarë të ndodhë/të përsëritet edhe te ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave, nëse ai ka ndikuar ose ka të ngjarë të ndikojë në funksionimin normal të infrastrukturave të tregut financiar dhe nëse ka kompromentuar ose ka të ngjarë të kompromentojë funksionimin e shëndoshë të sistemit financiar në tërësi. Ofruesit e shërbimeve të pagesave marrin në konsideratë dimensione të ndryshme, të tilla si: nëse komponenti/softueri i prekur është plotësisht në pronësi ose i ndarë me anëtarë të tjerë, nëse rrjeti i kompromentuar është i brendshëm ose i jashtëm dhe nëse ofruesi i shërbimit të pagesave ka ndërprerë ose ka të ngjarë ta ndërpresë përmbushjen e detyrimeve të tij në infrastrukturat e tregut financiar në të cilat është anëtar (pjesëmarrës).

3.8. ndikimi reputacional

3.8.1. OSHP-të duhet të marrin në konsideratë nivelin e vizibilitetit që incidenti ka fituar ose ka të ngjarë të fitojë në treg, sipas njohurive më të mira të tyre. Në veçanti, ofruesit e shërbimeve të pagesave marrin në konsideratë mundësinë që incidenti të shkaktojë dëm në shoqëri, si një tregues i mirë i mundësisë për të ndikuar në reputacionin e tyre. Ofruesit e shërbimeve të pagesave marrin parasysh nëse:

i) PSHP-të dhe/ose OSHP-të e tjera janë ankuar për ndikimin negativ të incidentit,

ii) ii) incidenti ka ndikuar në një proces të dukshëm të lidhur me shërbimin e pagesave dhe për këtë arsye ka të ngjarë të marrë ose ka marrë tashmë mbulueshmëri mediatike (duke marrë parasysh jo vetëm mediat tradicionale, si gazetat, por edhe blogjet, rrjetet sociale, etj.),

iii) iii) detyrimet kontraktuale nuk janë respektuar ose ka të ngjarë të mos respektohen, duke rezultuar në publikimin e veprimeve ligjore kundër OSHP-së, iv) kërkesat rregullatore nuk janë respektuar, duke rezultuar në vendosjen e masave mbikëqyrëse ose sanksioneve të cilat janë publikuar ose ka të ngjarë të publikohen, dhe v) i njëjti lloj incidenti ka ndodhur edhe më parë.

4. OSHP-të duhet ta vlerësojnë një incident duke përcaktuar për secilin kriter individual nëse kufijtë përkatës në Tabelën 1 janë arritur ose ka të ngjarë të arrihen përpara zgjidhjes së incidentit.

Tabela 1: Kufijtë

Kriteret	Ndikim i ulët	Ndikim i lartë
Transaksionet e prekura nga incidenti	> 10% e nivelit të rregullt të transaksioneve të OSHP (përsa i përket numrit të transaksioneve) **dhe** kohëzgjatja e incidentit > 1 orë* **ose**	>25% e nivelit të rregullt të transaksioneve të OSHP (përsa i përket numrit të transaksioneve) **ose** > 15 000 000 euro

	> 5000,000 euro **dhe** kohëzgjatja e incidentit > 1 orë*	
PSHP-të e prekura nga incidenti	> 5,000 **dhe** kohëzgjatja e incidentit > 1 orë* **ose** > 10% e PSHP-ve të OSHP-së **dhe** kohëzgjatja e incidentit > 1 orë*	> 50,000 **ose** > 25% e PSHP-ve të OSHP-së
Kohëzgjatja ndërprerjes së shërbimeve	> 2 orë	Nuk aplikohet
Shkelja e sigurisë së rrjetit ose sistemeve të informacionit	Po	Nuk aplikohet
Ndikimi ekonomik	Nuk aplikohet	> Maksimumi (0,1% kapitali i nivelit 1**, 200,000 euro) **ose** > 5,000,000 euro
Niveli i lartë i përshkallëzimit të brendshëm	Po	Po, dhe një gjendje krize (ose ekuivalente) ka të ngjarë të aktivizohet
OSHP-të e tjera ose infrastruktura përkatëse që mund të preket nga incidenti	Po	Nuk aplikohet
Ndikimi reputacional	Po	Nuk aplikohet

* Kufiri në lidhje me kohëzgjatjen e incidentit për një periudhë më të gjatë se një orë zbatohet vetëm për incidentet operacionale që ndikojnë në aftësinë e OSHP-së për ta inicuar dhe/ose për ta procesuar transaksionin.

* Kapitali i nivelit 1 siç përcaktohet në nenin 6 të rregullores për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave.

5. OSHP-të duhet t'u drejtohen vlerësimeve nëse nuk kanë të dhëna reale për t'i mbështetur gjykimet e tyre nëse një kufi i caktuar është arritur ose do të arrihet përpara se të zgjidhet incidenti (p.sh. kjo mund të ndodhë gjatë fazës fillestare të hetimit).

6. OSHP-të duhet ta kryejnë këtë vlerësim në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së incidentit, në mënyrë që të identifikojnë çdo ndryshim të mundshëm të statusit, në kahun rritës (nga jomadhor në madhor) ose në kahun zbritës (nga madhor në jomadhor). Çdo riklasifikim i incidentit nga madhor në jomadhor duhet t'i komunikohet BQK-së në përputhje me kërkesat e nenit 4, paragrafi 4, nënparagrafi 4.5 të kësaj Rregullore, pa vonesa të pajustifikuara.

Neni 4
Procesi i njoftimit

1. OSHP-të duhet t'i mbledhin të gjitha informacionet relevante, ta prodhojnë një raport incidenti duke plotësuar modelin në Shtojcë dhe t'ia dorëzojnë atë BQK-së. OSHP-të duhet t'i plotësojnë të gjitha fushat e shabllonit duke i ndjekur udhëzimet e dhëna në Shtojcën 2.

   1.1. OSHP-të duhet ta përdorin të njëjtin shabllon kur t'i dorëzojnë raportet fillestare, të ndërmjetme dhe përfundimtare në lidhje me të njëjtin incident. Prandaj, OSHP-të duhet ta plotësojnë një shabllon të vetëm në mënyrë graduale dhe t'i përditësojnë, aty ku është e aplikueshme, informatat e dhëna me raportet e mëparshme;

   1.2. OSHP-të duhet t'i paraqesin BQK-së, nëse është e aplikueshme, një kopje të informatave të ofruara (ose që do t'iu ofrohen) përdoruesve të tyre, siç parashihet në paragrafin 2 të nenit 96 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, sapo të jetë në dispozicion;

   1.3. Me kërkesë të BQK-së, OSHP-të duhet të ofrojnë çdo dokument shtesë që plotëson informatat e dorëzuara me shabllonin e standardizuar. OSHP-të duhet të ndjekin çdo kërkesë nga BQK-ja për të ofruar informata apo sqarime shtesë në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar tashmë;

   1.4. Çdo informacion shtesë i përfshirë në dokumentet e ofruara nga OSHP-të për BQK-në, qoftë me iniciativën e OSHP-së ose me kërkesë të BQK-së në përputhje me nënparagrafin 1.3, duhet të pasqyrohet nga OSHP-ja në shabllonin sipas paragrafit 1;

   1.5. OSHP-të duhet ta ruajnë gjithmonë konfidencialitetin dhe integritetin e informacionit të shkëmbyer dhe autenticitetin e duhur të tyre ndaj BQK-së.

2. Raporti fillestar

   2.1. OSHP-të duhet ta dorëzojnë një raport fillestar në BQK pasi një incident operacional ose i sigurisë është klasifikuar si madhor. BQK-ja duhet ta pranojë marrjen e raportit fillestar pa vonesa të panevojshme dhe të caktojë një kod unik referimi që identifikon pa mëdyshje incidentin. OSHP-të duhet të tregojnë këtë kod referimi kur dorëzojnë një përditësim qoftë për raportin fillestar ose për raportet e ndërmjetme dhe përfundimtare që lidhen me të njëjtin incident, përveç nëse raportet e ndërmjetme dhe përfundimtare dorëzohen së bashku me raportin fillestar;

   2.2. OSHP-të duhet ta dërgojnë raportin fillestar në BQK brenda katër orëve nga momenti kur incidenti operacional ose i sigurisë është klasifikuar si madhor. Nëse dihet se kanalet e raportimit të BQK-së nuk janë të disponueshme ose nuk funksionojnë në atë kohë, OSHP-të duhet ta dërgojnë raportin fillestar sapo kanalet të bëhen sërish të disponueshme/funksionale;

   2.3. OSHP-të duhet ta klasifikojnë incidentin në përputhje me paragrafët 1 dhe 4 të nenit 3 në kohën e duhur pasi incidenti të jetë zbuluar, por jo më vonë se 24 orë pas zbulimit të incidentit, dhe pa vonesa të panevojshme pasi informatat e kërkuara për klasifikimin e incidentit të jenë në dispozicion për OSHP-në. Nëse nevojitet kohë më e gjatë për klasifikimin e incidentit, OSHP-të duhet t'i shpjegojnë në raportin fillestar të dorëzuar në BQK arsyet për këtë;

   2.4. OSHP-të duhet gjithashtu ta dorëzojnë një raport fillestar në BQK kur një incident i mëparshëm jomadhor është riklasifikuar si incident madhor. Në këtë rast, OSHP-të duhet

t'ia dërgojnë raportin fillestar BQK-së menjëherë pasi të identifikohet ndryshimi i statusit, ose nëse dihet se kanalet e raportimit të BQK-së nuk janë të disponueshme ose nuk funksionojnë në atë kohë, sapo ato të bëhen përsëri të disponueshme/funksionale;

2.5. OSHP-të duhet të ofrojnë informata të përmbledhura në raportet e tyre fillestare (p.sh. seksioni A i shabllonit), duke paraqitur kështu disa karakteristika bazë të incidentit dhe pasojat e tij të parashikuara bazuar në informatat e disponueshme menjëherë pasi ai është klasifikuar si madhor. OSHP-të duhet të përdorin vlerësime të përafërta kur të dhënat nuk janë të disponueshme.

3. Raporti i ndërmjetëm

3.1. OSHP-të duhet ta dorëzojnë raportin e ndërmjetëm kur aktivitetet e rregullta janë rikuperuar dhe biznesi është kthyer në normalitet, duke e informuar BQK-në për këtë rrethanë. OSHP-të duhet të konsiderojnë se biznesi është kthyer në normalitet kur aktiviteti/operacionet rikthehen me të njëjtin nivel shërbimi/kushte siç përcaktohen nga OSHP-ja ose të përcaktuara nga jashtë nga një marrëveshje e nivelit të shërbimit (kohët e përpunimit, kapaciteti, kërkesat e sigurisë, etj.), dhe kur masat emergjente nuk janë më në fuqi. Raporti i ndërmjetëm duhet të përmbajë një përshkrim më të detajuar të incidentit dhe pasojave të tij (seksioni B i shabllonit);

3.2. Nëse aktivitetet e rregullta ende nuk janë rikuperuar, OSHP-të duhet t'ia dorëzojnë një raport të ndërmjetëm BQK-së brenda tri ditëve pune nga dorëzimi i raportit fillestar;

3.3. OSHP-të duhet t'i përditësojnë informatat e dhëna tashmë në seksionet A dhe B të shabllonit kur ato bëhen të vetëdijshme për ndryshime të rëndësishme që nga paraqitja e raportit të mëparshëm (p.sh. nëse incidenti është përshkallëzuar ose zvogëluar, shkaqe të reja të identifikuara ose veprime të ndërmarra për ta zgjidhur problemin). Kjo përfshin rastin kur incidenti nuk është zgjidhur brenda tri ditëve të punës, gjë që do të kërkonte që OSHP-të ta dorëzonin një raport shtesë të ndërmjetëm. Në çdo rast, OSHP-të duhet ta dorëzojnë një raport shtesë të ndërmjetëm me kërkesë të BQK-së.

3.4. Si në rastin e raporteve fillestare, kur të dhënat nuk janë të disponueshme, OSHP-të duhet t'i përdorin vlerësimet e përafërta.

3.5. Nëse biznesi kthehet në normalitet përpara se të kenë kaluar katër orë që nga klasifikimi i incidentit si madhor, OSHP-të duhet të synojnë ta dorëzojnë njëkohësisht raportin fillestar dhe atë të ndërmjetëm (d.m.th. plotësimin e seksioneve A dhe B të shabllonit) brenda afatit prej katër orësh.

4. Raporti përfundimtar

4.1. OSHP-të duhet ta dorëzojnë një raport përfundimtar kur të bëhet analiza e shkakut rrënjësor (pavarësisht nëse masat zbutëse janë zbatuar tashmë ose është identifikuar shkaku përfundimtar) dhe kur ka shifra reale në dispozicion për ta zëvendësuar çdo vlerësim të përafërt të mundshëm;

4.2. OSHP-të duhet t'ia dorëzojnë raportin përfundimtar BQK-së më së largu 20 ditë pune pasi të konsiderohet se puna është kthyer në normalitet. OSHP-të që kanë nevojë për zgjatje të këtij afati (p.sh. kur nuk ka shifra reale mbi ndikimin në dispozicion ose shkaqet rrënjësore nuk janë identifikuar ende), duhet ta kontaktojnë BQK-në para se të kalojë koha dhe ta japin një arsyetim adekuat për vonesën, si dhe një datë të re të përafërt për raportin përfundimtar;

4.3. Nëse OSHP-të janë në gjendje t'i ofrojnë të gjitha informatat e kërkuara në raportin përfundimtar (p.sh. seksioni C i shabllonit) brenda afatit prej katër orësh që kur incidenti është klasifikuar si madhor, ato duhet të synojnë t'i japin informatat në lidhje me raportet fillestare, të ndërmjetme dhe përfundimtare së bashku;

4.4. OSHP-të duhet t'i përfshijnë në raportin e tyre përfundimtar informatat e plota, p.sh.: i) shifrat reale mbi ndikimin në vend të vlerësimeve (si dhe çdo përditësim tjetër të nevojshëm në seksionet A dhe B të shabllonit), dhe ii) seksionin C të shabllonit që përfshin, nëse dihet tashmë, shkakun rrënjësor dhe një përmbledhje të masave të miratuara ose të planifikuara për t'u marrë për ta eliminuar problemin dhe për ta parandaluar rishfaqjen e tij në të ardhmen;

4.5. OSHP-të duhet ta dërgojnë gjithashtu një raport përfundimtar kur, për shkak të vlerësimit të vazhdueshëm të incidentit, ato identifikojnë se një incident tashmë i raportuar nuk i plotëson më kriteret për t'u konsideruar madhor dhe nuk pritet t'i përmbushë ato kritere përpara se incidenti të zgjidhet. Në këtë rast, OSHP-të duhet ta dërgojnë raportin përfundimtar sapo të konstatohet kjo rrethanë dhe në çdo rast brenda afatit për paraqitjen e raportit të radhës. Në këtë situatë, në vend që ta plotësojnë seksionin C të shabllonit, OSHP-të duhet ta kontrollojnë kutinë "incidenti i riklasifikuar si jomadhor" dhe të japin një shpjegim të arsyeve që e justifikojnë këtë riklasifikim.

Neni 5
Raportim i deleguar dhe i konsoliduar

1. Aty ku lejohet nga BQK-ja, OSHP-të të cilat delegojnë detyrimet e raportimit sipas Ligjit për Shërbimet e Pagesave një pale të tretë, duhet ta informojnë BQK-në dhe të sigurojnë përmbushjen e kushteve të mëposhtme:

   1.1. Kontrata formale ose, aty ku është e aplikueshme, aranzhimet e brendshme ekzistuese brenda një grupi që mbështet raportimin e deleguar ndërmjet OSHP-së dhe palës së tretë, që përcakton në mënyrë të qartë ndarjen e përgjegjësive të të gjitha palëve. Në veçanti, ajo thekson qartë se, pavarësisht nga delegimi i mundshëm i detyrimeve të raportimit, OSHP-ja e prekur mbetet plotësisht përgjegjëse dhe llogaridhënëse për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në nenin 96 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave dhe për përmbajtjen e informatave që i janë dhënë BQK-së;

   1.2. Delegimi përputhet me kërkesat për jashtë kontraktimin e funksioneve të rëndësishme operacionale të përcaktuara në:

      1.2.1. Nenin 21, paragrafi 5, i Ligjit për Shërbimet e Pagesave në lidhje me institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike;

      1.2.2. Rregullore për aranzhmanet e kontraktimit të jashtëm në lidhje me të gjitha OSHP-të.

   1.3. Informatat i dorëzohen BQK-së paraprakisht dhe, në çdo rast, duke e ndjekur çdo afat dhe procedurë të përcaktuar nga BQK-ja, aty ku është e aplikueshme.

   1.4. Konfidencialiteti i të dhënave të ndjeshme dhe cilësia, konsistenca, integriteti dhe besueshmëria e informacionit që duhet t'i ofrohet BQK-së sigurohen siç duhet.

2. OSHP-të që dëshirojnë ta lejojnë palën e tretë të caktuar t'i përmbushë detyrimet e raportimit në mënyrë të konsoliduar (p.sh. duke e paraqitur një raport të vetëm duke iu referuar disa OSHP-ve të prekura nga i njëjti incident madhor operacional ose i sigurisë), duhet ta informojnë BQK-në, të sigurojnë informacionet e kontaktit të përfshira në "OSHP-në e prekur" në shabllon dhe të sigurohen që të përmbushen kushtet e mëposhtme:

   2.1. Përfshirja e kësaj dispozite në kontratën që mbështet raportimin e deleguar;

   2.2. Kushtëzimi i raportimit të konsoliduar që incidenti të jetë shkaktuar nga një ndërprerje në shërbimet e ofruara nga pala e tretë;

   2.3. Kufizimi i raportimit të konsoliduar në OSHP-të e themeluara në Kosovë;

   2.4. Sigurimi i një liste të të gjitha OSHP-ve të prekura nga incidenti;

   2.5. Sigurimi që pala e tretë ta vlerësojë materialitetin e incidentit për çdo OSHP të prekur dhe të përfshijë në raportin e konsoliduar vetëm ato OSHP për të cilat incidenti është klasifikuar si madhor; për më tepër, sigurimi që, në rast dyshimi, një OSHP të përfshihet në raportin e konsoliduar për sa kohë që nuk ka prova që e konfirmojnë të kundërtën;

   2.6. Sigurimi që kur ka fusha të shabllonit ku një përgjigje e përbashkët nuk është e mundur (p.sh. seksionet B2, B4 ose C3 të shabllonit), pala e tretë ose i) i plotëson ato individualisht për çdo OSHP të prekur, duke specifikuar më tej identitetin e secilës OSHP me të cilin lidhet informacioni, ose ii) përdor vlerat kumulative të vëzhguara ose të vlerësuara për OSHP-të;

   2.7. Pala e tretë e mban të informuar OSHP-në gjatë gjithë kohës për të gjitha informatat relevante në lidhje me incidentin dhe të gjitha ndërveprimet që mund të kenë me BQK-në dhe për përmbajtjen e tij, por vetëm deri në masën e mundshme për të shmangur çdo shkelje të konfidencialitetit në lidhje me informacionin që lidhet me OSHP-të e tjera.

3. OSHP-të nuk duhet t'i delegojnë obligimet e tyre të raportimit përpara se ta informojnë BQK-në ose pasi të jenë njoftuar se marrëveshja e jashtë kontraktimit nuk i plotëson kërkesat e përmendura në nënparagrafin 1.2 të paragrafit 1 më lart.

4. OSHP-të që dëshirojnë ta tërheqin delegimin e detyrimeve të tyre për raportim duhet t'ia komunikojnë këtë vendim BQK-së, duke ndjekur afatet dhe procedurat e përcaktuara nga kjo e fundit. OSHP-të duhet gjithashtu ta informojnë BQK-në për çdo zhvillim material që prek palën e tretë të caktuar dhe aftësinë e saj për t'i përmbushur detyrimet e raportimit.

5. OSHP-të duhet t'i përmbushin materialisht detyrimet e tyre të raportimit pa ndihmën e jashtme sa herë që pala e tretë e caktuar nuk e informon BQK-në për një incident madhor operacional ose të sigurisë në përputhje me nenin 96 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave dhe me këtë Rregullore. OSHP-të duhet gjithashtu të sigurojnë që një incident të mos raportohet dy herë, individualisht nga OSHP-ja në fjalë dhe përsëri nga pala e tretë.

6. OSHP-të duhet të sigurojnë që, në situatën kur një incident është shkaktuar nga një ndërprerje në shërbimet e ofruara nga një ofrues i shërbimit teknik (ose një infrastrukturë) që prek shumë OSHP, raportimi i deleguar i referohet të dhënave individuale të OSHP-së (përveç në rastin e raportimit të konsoliduar).

Neni 6
Politika operative dhe e sigurisë

OSHP-të duhet të sigurojnë që politika e tyre e përgjithshme operative dhe e sigurisë të përcaktojë qartë të gjitha përgjegjësitë për raportimin e incidenteve sipas Ligjit për Shërbimet e Pagesave, si dhe proceset e zbatuara për t'i përmbushur kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore.

Neni 7
Shtojcat

Pjesë përbërëse e kësaj rregullore është Shtojca 1 Shablloni i raportimit për ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe Shtojca 2 Udhëzimet drejtuar autoriteteve kompetente (BQK) për kriteret për vlerësimin e rëndësisë së incidentit dhe detajet e raporteve të incidentit që duhet të ndahen me autoritetet e tjera vendore.

KAPITULLI III

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 8
Periudha kalimtare

Të gjitha OSHP-të e licencuara, të autorizuara ose të regjistruara nga BQK-ja, do t'i përshtatin plotësisht aktivitetet dhe funksionimin e tyre me dispozitat e kësaj Rregulloreje brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Rregullores.

Neni 10
Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje do t'i nënshtrohet masave ndëshkuese administrative, siç janë përcaktuar në nenin 67 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës , të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -150 dhe paragrafin 2, nënparagrafin 2.4 të nenit 124 të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 10 –(dhjetë) ditë pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.

Dr.sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Shtojca 1: Shablloni i raportimit për Ofruesit e Shërbimeve të Pagesave

Raporti fillestar

Major Incident Report

Major Incident Report

within 20 working days after the submission of the intermediate report

Please describe:
(applicable for incidents reclassified as non-major)

Reset dropdown selections

Report date (DD/MM/YYYY) | Time (HH:MM)

C - Final report

If no intermediate report has been sent, please complete also section B

C 1 - GENERAL DETAILS

Update of the information from the initial report and the intermediate report(s)	
Changes made to previous reports	
Any other relevant information	
Are all original controls in place? If "No", specify which controls and the additional period required for their restoration	

C 2 - ROOT CAUSE ANALYSIS AND FOLLOW UP

What was the root cause (if already known)?	☐ Malicious action	☐ Process failure	☐ System failure	☐ Human error	☐ External event	☐ Other
Please specify:	☐ Malicious code ☐ Information gathering ☐ Intrusions ☐ Distributed/Denial of service attack (D/DoS) ☐ Deliberate internal actions ☐ Deliberate external physical damage ☐ Information content security ☐ Fraudulent actions ☐ Other	☐ Deficient monitoring and control ☐ Communication issues ☐ Improper operations ☐ Inadequate change management ☐ Inadequacy of internal procedures and documentation ☐ Recovery issues ☐ Other	☐ Hardware failure ☐ Network failure ☐ Database issues ☐ Software/application failure ☐ Physical damage ☐ Other	☐ Unintended ☐ Inaction ☐ Insufficient resources ☐ Other	☐ Failure of a supplier/technical service provider ☐ Force majeure ☐ Other	
If 'Other', please specify:						
Other relevant information on the root cause						
Main corrective actions/measures taken or planned to prevent the incident from happening again in the future, if already known						

C 3 - ADDITIONAL INFORMATON

Has the incident been shared with other PSPs for information purposes?	If 'Yes', please provide details:	
Has any legal action been taken against the PSP?	If 'Yes', please provide details:	
Assessment of the effectiveness of the action taken	Please provide details:	

Raport i ndërmjetëm



Major Incident Reporte

Intermediate report — maximum of 3 working days from the submission of the initial report

Reset all replicated selections

Report date (DD/MM/YYYY) | Time (HH:MM)

B - Intermediate report

B 1 - GENERAL DETAILS

More detailed description of the incident:

What is the specific issue?

How did the incident start?

How did it evolve?

What are the consequences (in particular for payment service users)?

Was the incident communicated to payment service users? — If 'Yes', please specify:

Was it related to a previous incidents? — If 'Yes', please specify:

Were other service providers/third parties affected or involved? — If 'Yes', please specify:

Was crisis management started (internal and/or external)? — If 'Yes', please specify:

Date and time of beginning of the incident (If already identified) (DD/MM/YYYY HH:MM)

Date and time when the incident was restored or is expected to be restored (DD/MM/YYYY HH:MM)

Functional areas affected

Authorisation/Authentication | Direct settlement | Clearing | Indirect settlement | Other | If 'Other', please specify:

Changes made to previous reports

B 2 - INCIDENT CLASSIFICATION / INFORMATION ON THE INCIDENT

Transactions affected

Impact level

Number of transactions affected

As a % of regular number of transactions

Value of transactions affected in EUR

Duration of the incident (only applicable to operational incidents)

Comments:

Payment service users affected

Impact level

Number of payment service users affected

As a % of total payment service users

Breach of security of network or information systems

Describe how the network or information systems have been affected

Service downtime

Total service downtime — Days: | Hours: | Minutes:

Economic impact

Impact level

Direct costs in EUR

Indirect costs in EUR

High level of internal escalation

Describe the level of internal escalation of the incident, indicating if it has triggered or is likely to trigger a crisis mode (or equivalent) and/if so, please describe

Other PSPs or relevant infrastructures potentially affected

Describe how the incident could affect other PSPs and/or infrastructures

Reputational impact

Describe how the incident could affect the reputation of the PSP (eg. media coverage, publication of legal actions or infringements of law, ..)

B 3 - INCIDENT DESCRIPTION

Type of incident

Cause of incident

Under investigation | Malicious action | Process failure | System failure | Human error | External event

If 'Other', please specify:

Was the incident affecting you directly, or indirectly through a service provider?

If 'Indirectly', please provide the service provider's name:

B 4 - INCIDENT IMPACT

Overall impact

Integrity | Confidentiality | Availability | Authenticity

Commercial channels affected

Branches | Telephone banking | Point of Sale | IT banking | Mobile banking | Other | E-commerce | ATM

If 'Other', please specify:

Payment services affected

Cash placement on a payment account | Credit transfers | Money remittance | Cash withdrawal from a payment account | Direct debits | Payment initiation services | Operations required for operating a payment account | Card payments | Account information services | Acquiring of payment instruments | Issuing of payment instruments

B 5 - INCIDENT MITIGATION

Which actions/measures have been taken so far or are planned to recover from the incident?

Have the Business Continuity Plan and/or Disaster Recovery Plan been activated?

If so, when? (DD/MM/YYYY HH:MM)

If so, please describe

Raporti përfundimtar

Major Incident Report

Major Incident Report	within 20 working days after the submission of the intermediate report
Please describe: (applicable for incidents reclassified as non-major)	

Reset dropdown selections

Report date (DD/MM/YYYY) | Time (HH:MM)

C - Final report

If no intermediate report has been sent, please complete also section B

C 1 - GENERAL DETAILS

Update of the information from the initial report and the intermediate report(s)	
Changes made to previous reports	
Any other relevant information	
Are all original controls in place?	
If "No", specify which controls and the additional period required for their restoration	

C 2 - ROOT CAUSE ANALYSIS AND FOLLOW UP

What was the root cause (if already known)?

☐ Malicious action ☐ Process failure ☐ System failure ☐ Human error ☐ External event ☐ Other

Please specify:

Malicious action	Process failure	System failure	Human error	External event
Malicious code	Deficient monitoring and control	Hardware failure	Unintended	Failure of a supplier/technical service provider
Information gathering	Communication issues	Network failure	Inaction	Force majeure
Intrusions	Improper operations	Database issues	Insufficient resources	Other
Distributed/Denial of service attack (D/DoS)	Inadequate change management	Software/application failure	Other	
Deliberate internal actions	Inadequacy of internal procedures and documentation	Physical damage		
Deliberate external physical damage	Recovery issues	Other		
Information content security	Other			
Fraudulent actions				
Other				

If 'Other', please specify:

Other relevant information on the root cause	
Main corrective actions/measures taken or planned to prevent the incident from happening again in the future, if already known	

C 3 - ADDITIONAL INFORMATON

Has the incident been shared with other PSPs for information purposes?	If 'Yes', please provide details:
Has any legal action been taken against the PSP?	If 'Yes', please provide details:
Assessment of the effectiveness of the action taken	Please provide details:

Shtojca 2: -Udhëzimet drejtuar autoriteteve kompetente (BQK) për kriteret për vlerësimin e rëndësisë së incidentit dhe detajet e raporteve të incidentit që duhet të ndahen me autoritetet e tjera vendore

[referojuni tekstit origjinal në Udhëzimet e EBA – Udhëzimet 5 dhe 6]

Udhëzimi 1: Vlerësimi i rëndësisë së incidentit

1. BQK-ja duhet ta vlerësojë rëndësinë e një incidenti madhor operacional ose të sigurisë për autoritetet e tjera vendore, duke marrë si bazë opinionin e tyre vetanak profesional dhe duke përdorur kriteret e mëposhtme si tregues kryesor të rëndësisë së incidentit në fjalë: a.
   1.1. Shkaqet e incidentit janë brenda kompetencës rregullatore të autoritetit tjetër vendor (pra, fushës së tyre të kompetencës);
   1.2. Pasojat e incidentit kanë ndikim në objektivat e një autoriteti tjetër vendor (p.sh. ruajtja e stabilitetit financiar);
   1.3. Incidenti prek ose mund të prek PSHP-të në një shkallë të gjerë;
   1.4. Incidenti ka të ngjarë të marrë, ose ka marrë, mbulueshmëri të gjerë mediatike.
2. BQK-ja duhet ta kryejë këtë vlerësim në baza të vazhdueshme gjatë jetëgjatësisë së incidentit, për të identifikuar çdo ndryshim të mundshëm që mund ta bëjë relevant një incident që më parë nuk ishte konsideruar si i tillë.

Udhëzimi 2: Informatat që duhet ndarë

1. Pavarësisht çdo kërkese tjetër ligjore për t'i ndarë informatat e lidhura me incidentin me autoritetet e tjera vendore, BQK-ja duhet t'u ofrojë informata për incidente madhore operacionale ose të sigurisë autoriteteve vendore përkatëse të identifikuara pas zbatimit të Udhëzimit 1.1, minimalisht në kohën e marrjes së raporti fillestar (ose, në mënyrë alternative, raporti që nxiti ndarjen e informacionit) dhe kur njoftohen se biznesi është kthyer në normalitet (d.m.th raporti i ndërmjetëm).
2. BQK-ja duhet t'ua dorëzojë autoriteteve vendore përkatëse informatat e nevojshme për të ofruar një pasqyrë të qartë të asaj që ka ndodhur dhe pasojave të mundshme. Për ta bërë këtë, ajo duhet t'i sigurojë, minimalisht, informatat e dhëna nga OSHP-ja në fushat e mëposhtme të shabllonit (qoftë në raportin fillestar ose të ndërmjetëm):
   2.1. Datën dhe orën e klasifikimit të incidentit si madhor;
   2.2. Datën dhe orën e zbulimit të incidentit;
   2.3. Datën dhe orën e fillimit të incidentit;
   2.4. Datën dhe orën kur incidenti është restauruar ose pritet të restaurohet;
   2.5. Përshkrimin e shkurtër të incidentit (duke përfshirë pjesët jo të ndjeshme të përshkrimit të detajuar).
   2.6. Përshkrimin e shkurtër të masave të ndërmarra ose të planifikuara për t'u marrë për t'u rikuperuar nga incidenti;

2.7. Përshkrimin se si incidenti mund t’i ndikojë OSHP-të dhe/ose infrastrukturat e tjera;

2.8. Përshkrimin (nëse ka) e mbulueshmërisë mediatike;

2.9. Shkakun e incidentit.

3. BQK-ja duhet ta bëjë anonimizimin e duhur, sipas nevojës, dhe ta lërë jashtë çdo informacion që mund t'i nënshtrohet kufizimeve të konfidencialitetit ose pronës intelektuale përpara se të ndajë ndonjë informacion në lidhje me incidentin me autoritetet e tjera vendore përkatëse. Megjithatë, BQK-ja duhet t'u ofrojë autoriteteve vendore përkatëse emrin dhe adresën e OSHP-së raportuese kur autoritetet vendore të përmendura mund të garantojnë se informacioni do të trajtohet në mënyrë konfidenciale.

4. BQK-ja duhet të ruajë gjatë gjithë kohës konfidencialitetin dhe integritetin e informacionit të ruajtur dhe të shkëmbyer dhe vërtetimin e duhur të tyre ndaj autoriteteve vendore përkatëse. Në veçanti, BQK-ja duhet t'i trajtojë të gjitha informatat e marra sipas kësaj Rregulloreje në përputhje me detyrimet e fshehtësisë profesionale të përcaktuara në Ligjin për Shërbimet e Pagesave, pa paragjykuar kërkesat e tjera ligjore në fuqi.